

“Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më datë 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, ka kërkuar organit që ju përfaqësoni, sipas aplikimit nr.K-7730, datë 30.05.2014, mundësimin e nxjerrjes së aktit të kalimit të pronësisë mbi banesë si dhe mbi truallin funksional të saj. Edhe pse janë kryer veprime në procesin administrative të nisur prej Bashkisë, Tiranë, nuk është bërë e mundur prej saj përfundimi i procesit administrativ të nisur, në afatin e parashikuar në nenin 49 të Kodit të Procedurës Administrative.

Nëshkresën nr.K-7730, datë 31.12.2014, drejtuar ankuesit, Bashkia, Tiranë, shprehet, se, ka kërkuar K.H., plotësimin e dokumentacionit lidhur me përgatitjen e një plan rilevimi të saktë, sipas hartës treguese të Zyrës Vendore të Regjistrimit Pasurive të Paluajtshme, Tiranë. Përkundër këtij qëndrimi, ankuesit, shprehen se, plan rilevimet e përgatitura, respektivisht më datë 18.10.2014, prej Inxh Enver Vani apo më datë 27.06.2007, prej subjektit, Studio Topografike “Bylis”, pasqyrojnë në mënyrë të qartë dhe të saktë vendndodhjen e pasurisë (banesës) në posedim të ankuesve, e cila në plan rilevimet e përgatitura identifikohet me numër 1/2070.

Kjo pasuri, sipas ankuesve është e pasqyruar dhe në fragmentin e hartës, pjesë nga rielevi i Tiranë, Shk.1:500, Viti 1981-1982, azhornuar në Vitin 1999, lëshuar prej Arkivit Qendror Teknik i Ndërtimit, Tiranë, bashkëlidhur Shkresës nr.517 Prot, datë 28.03.2014, drejtuar z.K.H..

Referuar aktit, Harta Treguese e Regjistrimit që i bashkëlidhet Shkresës nr. s’ka, datë 28.05.2014, të ZVRPP, Tiranë, drejtuar ankuesit, shprehemi se, ky akt është absolutisht i pavlefshme në kuptim dhe zbatim të nenit 116/a të Kodit të Procedurës Administrative, pasi nuk identifikohet se cili organ e ka nxjerr. Ky akt nuk ka emrin e subjektit që e ka prodhuar, nënshkrimin apo vendosjen e vulës së ZVRPP, Tiranë, me rastin e lëshimit të këtij akti nga ana e saj.

Ndodhur në kushtet kur pasuria (banesa) në posedim të ankuesve, rregjistruar në rregjistrin e ZVRPP, Tiranë, me numër 1/270, do të jetë objekt shpronësimi për shkak të realizimit të projektit për ndërtimin “Unaza e Madhe e Tiranës”, segmenti rrugor “Komuna e Parisit– Rruga e Kavajës”, bën të domosdoshme për organin që ju përfaqësoni, marrjen e masave për përfundimin sa më parë të procesit administrative të nisur qysh më datë 30.05.2014, me rastin e administrimit të kërkesës së ankuesit K.H.

Duhet pasur parasysh se afati i vendosur në pikën 8.1 të VKM nr.133, datë 11.02.2015, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 608, datë 05.09.2012,”*, për përfundimin e procedurës administrative të lartpërmendur është 7 ditë, në rastet e realizimit të projekteve, investimeve për ndërtimin e infrastrukturës publike.

Ushtrimi i funksionit nga ana juaj, sikundër përcaktuar në pikën 4 të VKM nr.608, datë 05.09.2012, të ndryshuar, do të mundësojë respektimin e të drejtës së pronës për cilindo subjekt posedues të ndërtimit të kryer para datës 10.08.1991. Në kushtet kur organi që ju përfaqësoni, disponon aktet e vëna në dispozicion prej z.H, të cilat sipas tij provojnë kryerjen e ndërtimit (banesës) para datë 10.08.1991, përfundimi i procedurës administrative sa më parë, do të jetë jo vetëm tregues i respektimit të përcaktimit të kryer në pikën 4 dhe 8.1., të VKM nr.608, datë 05.09.2012, të ndryshuar, neni 100 I K.Pr.A., por edhe tregues i respektimit të së drejtës të pronës për ankuesit, parimit për

zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës si dhe nenin 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, miratuar me Ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe parimit të ligjshmërisë, sigurisë juridike, transparencës, barazisë para ligjit, të parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative.

Për arsytet e bërë të ditura, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”:

REKOMANDON

Marrjen e masave për përfundimin sa më parë të procesit administrative të nisur mbi bazë të kërkesës datë 30.05.2014, për nxjerrjen e aktit për miratimin e kalimit të pronësisë së banesës dhe truallit funksional të saj të ndërtuar prej shtetasit K.H., ndodhur në Selitë e Vogël, Tiranë, pasuri e rregjistruar në rregjistrin e ZVRPP, Tiranë, me nr. 1/270.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet kryer brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Bashkëlidhur ju dërgojmë;

Kopje të shkresës nr.517 Prot, datë 28.03.2014, së bashku me fragmentin e hartës, pjesë nga rielevi i Tiranë, Shk.1:500, Viti 1981-1982, azhornuar në Vitin 1999, lëshuar prej Arkivit Qendror Teknik i Ndërtimit, Tiranë, drejtuar z.K.H.

Kopje të shkresës nr.2010/1 prot, datë 06.03.2015, të Bashkisë, Tiranë, drejtuar Avokatit të Popullit.

Kopje të shkresës nr. s’ka, datë 28.05.2014, të ZVRPP, Tiranë, së bashku me Harta Treguese e Regjistrimit për pasurinë 1/270, drejtuar ankuesit,

Kopje të Plan rilevimit për pasurinë nr.1/220, ZK 8260, përgatitur prej Inxh E.V.

Kopje e Plan Rilevimit për pasurinë nr.1/270, ZK 8260, përgatitur prej subjektit, Studio Topografike “Bylis”

Me besim në bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI